



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria-Vlada-Government

MINISTRIA E FINANCAVE  
MINISTARSTVO ZA FINANCIJE / MINISTRY OF FINANCE

**Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Parandalimin  
dhe Luftimin e Ekonomisë Jo-formale, Pastrimin e Parave,  
Financimin e Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2019-2023**

**Prishtinë, Maj 2019**

## Përmbajtja:

Lista e shkurtesave .....	3
<b>I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....</b>	<b>4</b>
HYRJE .....	8
Konteksti .....	8
Mënyra e Trajtimit .....	9
Aktorët Publikë .....	9
<b>II. METODOLOGJIA .....</b>	<b>11</b>
<b>III. SFONDI I PROBLEMIT .....</b>	<b>13</b>
<b>IV. VIZIONI DHE OBJEKTIVAT .....</b>	<b>18</b>
Objektivi Strategjik I: Përmirësimi i cilësisë së qeverisjes në ekonomi nëpërmjet identifikimit, analizimit, trajtimit dhe monitorimit të luftimit të ekonomisë joformale, pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit .....	18
Objektivi Strategjik II: Rritja e burimeve financiare për shërbimet publike si rezultat i të hyrave shtesë tatimore dhe nga konfiskimi i pasurisë së paligjshme .....	18
Objektivat Specifikë.....	19
Objektivi Specifik I.1: .....	21
Objektivi Specifik I.2: .....	21
Objektivi Specifik I.3: Përmirësimi cilësor i kapaciteteve institucionale dhe bashkërendimit për zbatim më të mirë të politikave të miratuara. ....	22
Objektivi Specifik II.1: Përmirësimi sasior i të dhënave për të mundësuar zhvillimin e politikave që në mënyrë të efektshme kontribuojnë në uljen e ekonomisë joformale. ....	24
Objektivi Specifik II.2: Rritja sasiore e përmbushjes vullnetare përmes ngritjes së vetëdijes, raportimit dhe masave ligjore të kufizimit. ....	24
Objektivi Specifik II.3: Përmirësimi sasior i kapaciteteve institucionale dhe bashkërendimit për zbatim më të mirë të politikave të miratuara. ....	24
<b>V. ARANZHIMET E ZBATIMIT, MONITORIMIT DHE RAPORTIMIT.....</b>	<b>26</b>
Grupi Punues Qeveritar .....	27
Sekretariati i Grupit Punues Qeveritar .....	27
Institucionet e obliguara të sektorit publik, privat dhe të tretë.....	28
Hartimi, rishikimi dhe miratimi i strategjisë kombëtare dhe plani i veprimit.....	28
Zbatimi dhe monitorimi i strategjisë kombëtare dhe planit të veprimit.....	29
Treguesit për monitorimin e Strategjisë .....	30
<b>VI. NDIKIMI BUXHETOR DHE ZBATIMI I STRATEGJISË.....</b>	<b>33</b>
<b>SHTOJCAT.....</b>	<b>33</b>

## Lista e shkurtesave

ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
ARBK	Agjencioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë
BB	Banka Botërore
BE	Bashkimi Evropian
BK	Bankat Komerçiale
BPV	Bruto Produkti Vendor
BQK	Banka Qendrore e Kosovës
DK	Dogana e Kosovës
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
FT	Financimi i Terrorizmit
MF	Ministria e Financave
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
NjIF	Njësia e Inteligjencës Financiare
PK	Policia e Kosovës
PSH	Prokurori i Shtetit
PP	Pastrimi i Parave
SKZH	Strategjia Kombëtare e Zhvillimit
TAK	Tatimi në të Ardhura të Korporatave
TAP	Tatimi në të Ardhura Personale
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar

## **Lista e tabelave**

Figura nr. 1: Procesi i Hartimit të Strategjisë .....	12
Figura nr. 2: Shkalla në % e ekonomisë joformale në Kosovë në raport me vendet e rajonit dhe vendet e BE-së, 2017. ....	16
Figura nr. 3: Skema e Problemeve të Identifikuara dhe Përcaktimit të Objektivave.....	20

## **Lista e Shtojcave:**

- PLANI I VEPRIMIT 2019-2021, lidhur me zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Jo-formale, Pastrimin e Parave, Financimin e Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2019-2023.
- Dokumenti i Kostos
- Pasaporta e Indikatorëve

## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

**Strategjia e luftës kundër ekonomisë joformale, parandalimit të pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2019-2023 është një dokument i hartuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës në bashkëpunim të plotë me partnerët e saj.** Ky dokument mbulon tërësinë e masave që Qeveria synon të realizojë përmes institucioneve të saj ligj zbatuese parandalimin e të gjitha formave të ekonomisë joformale, **parandalimit të pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe Krimeve Financiare** në sektorë të ndryshëm të aktiviteteve ekonomike në Kosovë përmes Planit të Veprimit 2019-2023. Në përputhje me Udhëzimin Administrativ Nr. 07/2018 për planifikimin dhe hartimin e dokumenteve strategjike dhe planeve të veprimit, ky dokument u përpilua duke kaluar nëpër disa faza dhe më hollësisht në fazën e mbledhjes, studimit dhe analizës paraprake të të dhënave dhe dokumenteve që trajtojnë fenomenin e ekonomisë joformale në Kosovë, rajon dhe më gjerë, konsultimi në Institucionet e Kosovës, fazën e draftimit të strategjisë, fazën e konsultimit ndër-institucional dhe fazën e konsultimit publik përpara aprovimit në Qeveri të draftit përfundimtar të paraqitur në dt.... dhe të miratuar në dt. ...

Sfida kryesore e Qeverisë së Republikës së Kosovës është niveli i lart i ekonomisë joformale i cili ka një **efekt negativ në të hyrat për buxhetin e Kosovës, konkurrenca jo lojale, punësimi i padeklaruar** në këtë drejtim sektorët më problematikë me prezencë të ekonomisë joformale janë: sektori i ndërtimit, shërbimeve sidomos hoteleri, restorante, tregtia dhe transporti. Vlen të përmendet sektori i ndërtimit ku si rezultat i ndërtimeve masive pa leje (350,000 të identifikuara dhe të raportuara) mundësia e pastrimit të të hyrave nga aktivitete të paligjshme mbetet e lartë. Vlera e shmangieve tatimore dhe për rezultat dëmi për buxhetin e Kosovës në sektorin e ndërtimit vlerësohet të jetë jo më pak se 8 milion EUR kurse në tregti diku tek 11 milion EUR.

**Vizioni** i Strategjisë Kombëtare të Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Jo-formale, Pastrimin e Parave, Financimin e Terrorizmit dhe Krimeve Financiare (SLEJ) 2019-2023, është zhvillimi i një sistemi të qëndrueshëm në Kosovë për të luftuar ekonominë joformale, financimin e terrorizmit dhe krimet tjera financiare për tu integruar në luftën rajonale dhe ndërkombëtare për të siguruar paqen sociale, mirëqenien, dinjitetin, barazi dhe zhvillim të qëndrueshëm ekonomik në përputhje me politikat e Qeverisë së Kosovës.

Ky është vizioni që orienton masat dhe aktivitetet e parapara në këtë dokument. Përmirësimi i punësimit, i burimeve publike, dhe forcimi i shtetit të së drejtës dhe i mirëqeverisjes janë fushat kryesore që kjo Strategji synon me vizionin e dokumentit themeltar të zhvillimit në Kosovë.

Në dokumentin e paraqitur këto masa dhe veprime janë strukturuar mbi bazën e dy parimeve, **parimit të pajtueshmërisë** me ligjin dhe **parimit të shtrëngesës ligjore**. Masat e propozuara dhe veprimet e parapara për zbatimin e parimit të pajtueshmërisë së ligjeve synojnë krijimin e kushteve për t'u mundësuar qytetarëve të Kosovës të zgjedhin zbatimin e kuadrit ligjor në të gjitha

veprimtaritë ekonomike, si mënyra më racionale për të arritur të plotësojnë synimet e aktiviteteve të tyre të përditshme. Parimi i shtrëngesës ligjore është zbatuar për të krijuar normat apo instrumentet ligjore;

- i) në rast se ato nuk janë ende të pranishme për të rregulluar veprimtarinë shoqërore dhe
- ii) për të penalizuar devijimin nga norma ligjore për veprimtaritë, të cilat konsiderohen në shkëlqje të hapur të kuadrit rregullator në Kosovë.

**Objektivat strategjikë që synohen të arrihen nëpërmjet kësaj strategjie janë:**

- **Përmirësimi i cilësisë së qeverisjes në ekonomi nëpërmjet identifikimit, analizimit, trajtimit dhe monitorimit të luftimit të ekonomisë joformale, pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit**
- **Rritja e burimeve financiare për shërbimet publike si rezultat i të hyrave shtesë tatimore dhe nga konfiskimi i pasurisë së paligjshme**

Këto dy objektiva janë shprehje e përmirësimit sasior dhe cilësor, të cilat Qeveria mendon si themeltare për t'u përballur me sfidat dhe problemet e ekonomisë joformale. Po ashtu ato janë edhe një jetësim i angazhimeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës në dialogun me Bashkimin Evropian (BE) gjatë vitit 2018, përputhshmëri me dokumentin themeltar Strategjia Kombëtare e Zhvillimit (SKZH) dhe Programin e Reformave Ekonomike 2019-2021 dhe dokumente të tjera strategjike të Kosovës.

**Realizimi i objektivave strategjike të mësipërm do të bëhet nëpërmjet katër objektivave specifike sasior dhe 3 objektivave specifik cilësor, të cilat janë formuluar në pajtim me ciklin e formulimit dhe zbatimit të politikave publike.** Në pajtim me parimin e racionalitetit dhe koherencës këto objektiva veprojnë në dy nivele: së pari ato synojnë përmirësime cilësore të cilat nuk mund të arrihen pa përmirësime të mjaftueshme sasiore. Për pasojë ndryshimet cilësore të specifikuara në Objektivin Strategjik 1 janë menduar si të njëkohshme dhe po aq të rëndësishme sa ndryshimet sasiore të specifikuara si kushte për arritjen e Objektivit strategjik 2. Objektivat specifike kanë të bëjnë me rritjen e cilësisë së alternativave të konsideruara në procesin e gjenerimit të masave të politikave nga Qeveria, me përzgjedhjen e atyre masave që janë të përballueshme financiarisht dhe kanë ndikimin më të madh, me rritjen e efijencës operative në zbatimin e tyre si dhe me përmirësimin e aftësive njerëzore për t'i zbatuar të njëjtat. Strategjia parashikon një radhë aktiviteteve, të cilat u konsideruan si më të arsyeshmet nëpërmjet metodologjisë së evidentimit të problemeve dhe identifikimit të shkaqeve dhe pasojave. Në identifikimin e këtyre aktiviteteve është mbajtur parasysh jo vetëm eksperiencia dhe mendimi i autoriteteve publike dhe opinioni i qytetarëve por dhe rekomandimet e disa studimeve dhe misioneve të asistencës teknike në fushat që mbulohen nga kjo strategji sidomos nga Këshilli i Evropës dhe BE-së në përgjithësi, në kuadrin e Raportit të Vendit për Kosovën. Po ashtu, janë marr parasysh dhe rekomandimet e dhëna nga institucionet financiare ndërkombëtare që asistojnë Kosovën si Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe Banka Botërore (BB).

**Strategjia parashikon dhe kuadrin institucional të rishikimit, zbatimit dhe monitorimit me një radhë përgjegjësish të përcaktuara për disa nga institucionet dhe mekanizmat institucionalë, të cilët janë shpjeguar tek Kapitulli - Metodologjia i këtij dokumenti.** Ministria e Financave si bartëse e këtij dokumenti strategjik , mban përgjegjësinë kryesore për koordinimin e aktiviteteve lidhur me hartimin, rishikimin, miratimin, zbatimin dhe monitorimin e Strategjisë Kombëtare 2019-2023 dhe Planit të saj të Veprimit 2019-2021. Janë dy lloje raportesh, raporti gjashtëmujor dhe raporti vjetor ashtu siç kërkohet me Udhëzimin Administrativ 07/2018 të cilat do të kryhen për monitorimin, zbatimin dhe vlerësimin e zbatimit të Strategjinë për Luftimin e ekonomisë joformale.

Ministria e Financave në koordinim me institucionet mbështetëse kanë formuar strukturat koordinuese ndërministrare të cilat përfaqësohen në Grupin e Përhershëm Qeveritar, i cili është përgjegjës për hartimin, rishikimin, miratimin, zbatimin dhe monitorimin e Strategjisë Kombëtare 2019-2023.

Strategjia ka një efekt financiar prej 6,147,911 EUR, prej tyre 2,335,190 pritet të janë financime nga donatorët (BE, FMN, BB, USAID, Sida, UNDP etj.). Plani i veprimit 2019-2021 nuk krijon kosto shtesë buxhetore duke nënkuptuar se të gjitha aktivitetet të cilat dalin nga kjo strategji do të mbulohen nga ndarjet buxhetore të parapara për Institucionet që janë përgjegjëse për zbatimin e planit të veprimit të kësaj strategjie.

## HYRJE

### Konteksti

Strategjia dhe Plani i Veprimit për luftimin e ekonomisë joformale që paraqitet në këtë dokument është vazhdimësi e strategjisë paraprake 2014-2018.

Strategjia paraprake për parandalimin e ekonomisë joformale, ka pasur ndikim pozitiv në parandalimin dhe luftimin e ekonomisë joformale, duke rezultuar me rritje të vazhdueshme të hyrave totale nga dy agjencionet kryesore siç janë: DK dhe ATK, të cilat viteve të fundit kanë shënuar një rritje të vazhdueshme në mbledhjen e të hyrave (direkte dhe indirekte), një rritje pothuajse sa dyfishi i shkallës së rritjes së BPV-së për vitet përkatëse, gjë e cila ka reflektuar në zvogëlimin e hendekut tatimor.

Nga ana tjetër, NJIF-i, PK, PSH dhe organet tjera zbatuese kanë luajtur rol kyç në zbulimin dhe hetimin e krimeve financiare që ka rezultuar me rritjen e numrit të ndjekjeve penale, dënimeve si dhe në rritjen e vlerës së aseteve të konfiskuara të cilat janë përfituar nga krimi.

Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Joformale, Pastrimin e Parave, Financimin e Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2019-2023, paraqet vizionin dhe objektivat strategjike dhe specifike të Qeverisë së Kosovës për të luftuar ekonominë joformale në përgjithësi dhe parandaluar shfaqjet ekstreme të veprimeve ilegale të cilat favorizohen nga ekzistenca e ekonomisë joformale dhe kanë pasoja për funksionimin e shtetit të së drejtës dhe kohezionit shoqëror si korrupsion, radikalizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm, pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit. Dokumenti është në përputhje me Dokumentin e Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit dhe angazhimet e Kosovës në procesin e dialogut me partnerë strategjikë si BE dhe SHBA për përmirësimin e niveleve të funksionimit të shtetit ligjor dhe demokracisë, zhvillimit shoqëror, përparimin në rrugën e aderimit të ardhshëm në BE si garantues i stabilitetit në rajon.

**Ky dokument parashikon ndërlidhjen me dokumente të tjera strategjike, angazhime ekzistuese ose të ardhshëm të Qeverisë së Republikës së Kosovës në mënyrë që të shmangë mbivendosjet, kostot shtesë për shkak të dyfishimit të përpjekjeve në nivele të ndryshme të funksionit të qeverisë (politikave, aktivitete apo burime financiare dhe njerëzore të përdorura).**

Me poshtë po përmendim një listë të dokumenteve strategjike të cilëve u referohet ky dokument:

- “*Strategjia Kombëtare e Zhvillimit*” përkatësisht: Shtylla 2 Programi i Qeverisë: II. ZHVILLIMI EKONOMIK DHE PUNËSIMI - 'Qeveria zotohet se, në baza të rregullta vjetore, Buxheti do të rritet në linjë me rritjen ekonomike të vendit. Për më tepër, dhe si shtesë nga rritja ekonomike, buxheti do të shtohet si rezultat i zvogëlimit të hendekut tatimor, respektivisht masave për reduktimin e ekonomisë joformale'. QEVERISJA E MIRE DHE SUNDIMI I LIGJIT: Lufta kundër ekonomisë joformale, korrupsionit, përmirësimi i shërbimeve publike, rritja e cilësisë së masave, politikave bazuara mbi të dhënat.



- “Programi për Reforma në Ekonomi” 2019-2021, Masa e reformës # 11: Zvogëlimi i Ekonomisë Joformale
- “Strategjia e Reformës së Menaxhimit të Financave Publike 2016-2020”.
- “Konkluzionet e Përbashkëta të Dialogut Ekonomik dhe Financiar ndërmjet BE-së dhe Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë për vitin 2018”:Konkluzioni 5: Të miratohet Strategjia e re dhe Plani i Veprimit 2019-2023 për të luftuar ekonominë joformale e cila duhet të përfshijë objektiva cilësore dhe sasiore.
- Rekomandimet e “Raportit të Zgjerimit” BE 2018.
- Plani Kombëtar për zbatimin e MSA-së 2019;
- Agjenda e Reformave Evropiane;
- “Strategjia dhe Plani i Veprimit kundër Krimit të Organizuar” 2018-2022;
- “Strategjia mbi armët e vogla, të lehta dhe kontrollin e eksplozivëve” 2017-2021:
- “Strategjia për parandalimin e ekstremizmit dhe radikalizimit”.

## Mënyra e Trajtimit

Dokumenti edhe pse është në përputhje me Udhëzimin e Qeverisë së Kosovës për përgatitjen, miratimin, zbatimimin dhe monitorimin e dokumenteve strategjike, është ndërtuar mbi bazën e koncepteve të cilat janë artikulluar si të rëndësishme dhe të provuara për të garantuar suksesin e zbatimit të masave politikave qeveritare kundër ekonomisë joformale p.sh.:

- Parimi i Racionalitetit që kufizon përdorimin e alternativave të vendimmarrjes në minimumin e diktuar nga efektiviteti i arritjes së synimit subjekt i buxhetit të alokuar nga Qeveria e Kosovës.
- Parimi i Pajtueshmërisë Vullnetare dhe Parimi i Shtrengesës Ligjore përdorimi i të cilave duhet të jetë i justifikuar nga konteksti po aq sa dhe nga rezultati që synohet të arrihet.
- Parimi i Rëndësisë së Evidencës si i vetmi burim për të dalluar Faktin nga Opinioni në rastin e zgjedhjes dhe korrigjimit apo përmirësimit të alternativave të veprimit të paraqitura në këtë dokument për të arritur objektivat e synuara. Kjo do të thotë që ky dokument përpiqet të kualifikojë (në terma cilësorë të përjashtueshëm psh. po/jo) apo kuantifikojë (në terma sasiore të matshëm) informacionin mbi efektin e veprimeve si mënyra më efektive për të përcaktuar përparimin në zbatimin e strategjisë dhe Planit të Veprimit dhe informuar procesin e vendimmarrjes.

## Aktorët Publikë

Dokumenti i Strategjisë, duke marrë të mirëqenë natyrën politike të procesit të planifikimit strategjik dhe të buxhetimit, dhe në përputhje me instruksionet dhe Manualin e Zyrës së Planifikimit Strategjik, u hartua në konsultim me të gjithë aktorët publikë (qeveritarë dhe joqeveritarë) që preken direkt apo indirekt nga aktivitetet e parapara në strategji. Roli dhe pjesëmarrja e tyre është paraparë po ashtu dhe gjatë aktiviteteve të zbatimit të strategjisë në disa mënyra si informim, pjesëmarrje në zbatim, pjesëmarrje në monitorim, dhe në vendimmarrje për

zbatimin/korrigjimin e strategjisë gjatë periudhës kohore të paraparë në dokument. Pjesë aktorëve publikë janë dhe partnerët strategjikë të Kosovës që kanë asistuar Kosovën në Vazhdimësi në këtë fushë dhe që janë angazhuar konkretisht të asistojnë në të ardhmen. Këtu mund të përmenden: BE, FMN, BB, USAID, Sida, UNDP etj.

## I. METODOLOGJIA

Planifikimi strategjik për parandalimin e ekonomisë joformale, pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare në Kosovë, bazohet në menaxhimin e rrezikut, me qëllim që institucionet përkatëse kombëtare të jenë në gjendje të menaxhojnë dhe të kontrollojnë aktivitetet e tyre, në lidhje me rreziqet e mundshme në të ardhmen. Procedura e menaxhimit të rrezikut është në përputhje me Udhëzimin e Vlerësimit të rrezikut Kombëtar të TFVF-së për pastrimin e parasë dhe financimin e terrorizmit si dhe standardet ndërkombëtare ISO 31000 (2009) dhe 31010 (2009). Kjo Strategji është hartuar nga grupi punues përkatësisht Sekretariati i Grupit Punues Qeveritar për luftimin e ekonomisë joformale, i cili është themeluar me vendim të Ministrit të Financave Nr. 34/2018, datë: 18.07.2018.

Sekretariati është kryesuar nga përfaqësues nga Ministria e Financave. Anëtarët e tjerë janë përfaqësues nga:

- Ministria e Financave, kryesuese;
- Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale;
- Zyra e Kryeministrit;
- Ministria për Integrim Evropian;
- Policia e Kosovës;
- Dogana e Kosovës;
- Administrata Tatimore e Kosovës;
- Banka Qendrore e Kosovës;
- Njësia e Inteligjencës Financiare të Kosovës;
- Agjencia e Statistikave të Kosovës;
- Ministria e Tregtisë dhe Industrisë;
- Ministria e Drejtësisë;
- Koordinatori Kombëtar për luftimin e krimit ekonomik.

Metodologjia e hartimit të strategjisë, fazat kryesore:

- **Mbledhja, studimi dhe analiza e të dhënave:** Grupi punues gjatë kësaj faze ka analizuar gjendjen aktuale duke u bazuar në dokumentet që trajtojnë fenomenin e ekonomisë joformale, pastrimin e parasë, financimin e terrorizmit dhe krimet tjera financiare në Kosovë, rajon dhe më gjerë, vlerësimet e rreziqeve të identifikuara nga Institucionet vendore dhe vlerësimet nga Institucionet tjera ndërkombëtare lidhur me ekonominë joformale, si “Vlerësimi mbi shtrirjen e ekonomisë joformale në Kosovë” i publikuar në Nëntor të vitit 2017. Në këtë grup dokumentesh, grupi i punës i kushtoi rëndësi po ashtu strategjisë së mëparshme për luftimin e ekonomisë joformale 2014-2018 dhe Planit të Veprimit për vitin 2018. Në përfundim të kësaj faze e cila përfshiu disa takime dhe diskutime në grup ku u hartua një plan paraprak pune për dy fazat e mëtejshme: fazën e

konsultimit në institucionet e Kosovës dhe fazën tjetër të analizës së problemeve dhe draftimit të strategjisë. Kjo fazë përfundoi në 10 Shtator 2018.

- Diskutimi Ndër-Institucional:** Kjo fazë u orientua nga një seri pyetjesh dhe linjash drejtuese që orientonin procesin e konsultimeve në institucionet publike. Kjo seri u përpilua mbi bazën e analizës së fazës së parë dhe pati si qëllim orientimin e diskutimeve dhe të kërkesës për informacion të shtuar në institucionet publike duke mos i kufizuar ato në informacionet që do të kërkoheshin. Në fund të kësaj fazë, e cila zgjati 3 javë, shumë prej institucioneve identifikuan një seri aktiviteteve dhe prioriteteve për masat e politikave me qëllim parandalimin e ekonomisë joformale, pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Informacioni i grumbulluar u diskutua dhe në bazë të tij u hartua një kornizë e përgjithshme e strategjisë me një numër të parashikuar objektivash strategjike dhe specifike të cilat mund t'i jepnin përgjigje shqetësimeve kryesore të identifikuara nga Ministrinë e linjës. Korniza dhe një paraqitje grafike e strukturës së pemës së problemit ishin produktet kryesore që shërbyen si input i fazës së tretë të draftimit të Strategjisë.
- Hartimi i Strategjisë:** Punës së grupit punues i ka paraprirë shkëmbimi i matricës për shqyrtimin e problemeve të lidhura me dukuritë e ekonomisë joformale për çdo Institucion. Gjatë kësaj faze u trajtuan problemet, shkaqet, pasojat në nivele të ndryshme të ekonomisë dhe shoqërisë së Kosovës dhe u identifikuan një sërë aktiviteteve, të cilat mund të adresonin shkaqet në mënyrë që të eliminoheshin efektet negative të lidhura me problemet e identifikuara gjatë konsultimeve në institucione dhe nga puna në grup.
- Konsultimi ndër-institucional dhe konsultimit publik:** Procesi i konsultimit ndër-institucional dhe konsultimit publik është bazuar në rregulloren nr. 05/2016 për standardet minimale për procesin e konsultimit publik. Të gjitha komentet e pranuar gjatë kësaj faze janë trajtuar dhe janë marr parasysh gjatë finalizimit të këtij dokumenti. Vlen të përmendim se nga ana e Shoqërisë Civile nuk kemi pranuar komente edhe përkundër hapësirës së dhënë qoftë përmes platformës elektronike të konsultimit publik si dhe shpërndarjes së draftit të Strategjisë përmes postës elektronike tek përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile.

**Figura nr. 1: Procesi i Hartimit të Strategjisë**



## II. SFONDI I PROBLEMIT

### **Ekonomia joformale:**

Përkufizimi i ekonomisë joformale lidhet me fenomenet e evazionit fiskal dhe punës në të zezë, që ka të bëjë me aktivitetet ekonomike, ku për qëllim kanë shmangien e detyrimeve ligjore për të paguar taksa dhe mos respektimin e detyrimeve ligjore në përpjekje të sigurimit të përfitimeve të paligjshme në dëm të shtetit, por edhe të individit.

Ekonomia joformale njihet në praktikë edhe si: “*ekonomia në hije*”, “*ekonomia kesh*”, “*ekonomia e fshehur*”, “*ekonomia e paligjshme*”, “*sektori joformal*” etj.

### **Cilat janë shenjat e para, shkaqet dhe pasojat e ekonomisë joformale:**

Në Kosovë ekonomia joformale është shfaqur gjatë tranzicionit drejt një ekonomie të tregut, sidomos pas luftës së zhvilluar në Kosovë në vitin 1999, atëherë kur zhvillimi i kornizës ligjore, institucionale, fiskale dhe rregullatore, ka mbet pas zhvillimit të sektorit privat. Duke i shërbyer interesave të caktuara, të sunduar nga korrupsioni, ekonomia joformale si pjesë strukturale e ekonomisë, synon të bëhet sektori më dinamik i saj. Interesat e caktuara tek informaliteti, kanë gjetur instrumentin e duhur për të përfituar në mënyrë të menjëhershme shuma të mëdha në njërin anë, për të rrënuar në mënyrë selektive rivalet apo pjesët dinamike të ekonomisë, në anën tjetër.

### **Shkaqet kryesore të ekonomisë joformale janë:**

Mungesa e përgjegjësive dhe besimit në institucione zyrtare, niveli i ulët i vetëdijes dhe kulturës së qytetarëve lidhur me përmbushjen e detyrimeve, prezenca e dukurive korruptive në sektorin publik, burokracia, pamjaftueshmëria e zbatimit të ligjit dhe rregullave, pranimi i gjerë nga shoqëria dhe opinion publik i punës së paligjshme dhe ekonomisë joformale, identifikim i ulët i dukurive mos-përmbushëse nga organet e ndjekjes dhe mos aplikimi i ndëshkimeve adekuate vështirësojnë në masë përmbushjen e detyrimeve ligjore, kryerja në masë e transaksioneve financiare dhe pagesave jashtë sistemit bankar, etj.

### **Pasojat e ekonomisë joformale:**

Ekonomia joformale si fenomen, ka marrë shtrirje të gjerë në ekonominë e vendit. Kjo dukuri është zhvilluar me ritëm të shpejtë, dhe sot llogaritet të jetë në shifra të larta. Ky nivel i lartë i ekonomisë joformale, nuk është problem shqetësues vetëm i Qeverisë së vendit apo i Institucioneve që merren me monitorimin e kësaj dukurie, por është një problem shqetësues i gjithë shoqërisë në vend. Duke ju shmangur detyrimeve të ndryshme ndaj shtetit, subjekte të ndryshme fitojnë shuma të mëdha financiare në mënyrë të paligjshme. Ekonomia joformale në Kosovë krijon pasoja të mëdha negative, ku qytetarët vazhdojnë ti vuajnë pasojat çdo ditë.

Sektori joformal ka qenë vazhdimisht burim i abuzimeve nga më të ndryshme, duke filluar nga mos respektimi i të drejtave ndaj të punësuarve në këtë sektor si dhe mos marrja e masave adekuate

për siguri në punë. Si rrjedhojë numri i aksidenteve në vendin e punës vazhdon të rritet, shpeshherë edhe me pasoja tragjike.

Prezenca e ekonomisë joformale në vend dëmton ekonominë e tregut, dhe konkurrencën e drejtë në mes të bizneseve. Në këtë drejtim ajo gjithashtu paraqet pengesë të madhe në matjen e treguesve makroekonomik siç janë: bruto produkti vendor (BPV), shkalla e rritjes ekonomike dhe papunësisë, etj. të cilat reflektohen në krijimin e politikave ekonomike.

### **Si të veprohet**

Kujdes i veçantë duhet kushtuar sundimit të plotë të ligjit dhe rritjes së shkallës së ndërgjegjësimit të opinionit rreth pasojave të ekonomisë joformale. Duhet fokusuar në tejkalimin e e sfidave të rëndësishme, të cilat do të kenë ndikim pozitiv në zvogëlimin e nivelit të ekonomisë joformale dhe pasojave të tij. Përpara nesh shtrohen një sërë sfidash të rëndësishme të cilat do të kenë një impakt shumë pozitiv si në zvogëlimin e nivelit të ekonomisë joformale, ashtu edhe të pasojave të tij.

Prandaj në këtë drejtim duhet bërë më shumë punë si nga ana e Qeverisë, OJQ-ve, por edhe nga ana e institucioneve të tjera Kombëtare dhe Ndërkombëtare, që merren me monitorimin e kësaj dukurie.

Politikat të cilat ndikojnë në mënyrë direkte dhe indirekte në ekonominë joformale janë: Politikat makroekonomike (rritja ekonomike, politikat e punësimit, klima e biznesit, etj.), politikat financiare (politikat tatimore dhe taksave, sigurimet shoqërore, të pensioneve, sanksioneve, etj.), Legjislacioni i punës, dhe politikat e mbrojtjes sociale.

### **Pastrimi i Parave, Financimi i Terrorizmit dhe Krimet Financiare**

Paraja është faktori lëvizës në një varg krimesh, duke përfshirë trafikimin e drogës, korrupsionin, evazionin fiskal, mashtrimin, vjedhjen, trafikimin me qenien njerëzore dhe kontrabandën. Pastrimi i suksesshëm i parave lejon që kriminelët të gëzojnë fitime dhe të nxisin ciklin e kriminalitetit duke i bërë fondet në dispozicion për ri-investim në krimin. Këto krime shkaktojnë humbje të drejtpërdrejta financiare për individët, dëmtojnë komunitetin, dhe në disa raste edhe humbjen e jetës njerëzore. Kosova është e përkushtuar në zhvillimin dhe mbajtjen e politikave kundër pastrimit të parasë dhe luftimin e financimit të terrorizmit dhe krimin financiar për të rritur aftësinë e saj për t'iu përgjigjur këtyre rreziqeve.

Kosova e ka kryer vlerësimin e dytë kombëtar të rrezikut për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit të Kosovës (VKR - Nëntor, 2018). Synimi i vlerësimit ishte të identifikojë, kuptojë dhe vlerësojë rreziqet e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit me të cilin përballet Kosova, njëherit rezultatet e këtij vlerësimi janë përdorur edhe për draftimin e kësaj Strategjie. Rezultatet e vlerësimit të rrezikut kanë treguar se evazoni fiskal dhe korrupsioni gjenerojnë shumën më të madhe të të ardhurave. Evazoni fiskal në Kosovë është i lidhur fort me informalitetin e gjerë të ekonomisë që mundëson që të ardhurat të shkojnë nën apo të paregjistruara. Derisa disa forma të

korrupsionit gjenerojnë të ardhura në Kosovë, korrupsioni i lidhur me prokurimin shihet si gjenerimi i të ardhurave më të mëdha dhe shpesh është i lidhur me Personat e Ekspozuar Politik (PEP).

Trafikimi i drogës, kontrabanda, falsifikimi dhe pirateria e mallrave, mashtrimi, trafikimi i qenieve njerëzore dhe prostitucioni duhet të jenë në nivelin e dytë të gjenerimit të të ardhurave në Kosovë edhe llojet e krimit ku shumica e të ardhurave mendohet se dalin jashtë nga Kosova dhe në përgjithësi transferohen në vendin e lidhur me krimin.

Shumica e llojeve të krimit, posedojnë pjesën dërmuese të të ardhurave që marrin formën fillestare të parave të gatshme dhe përdorin metoda relativisht jo të sofistikuar të pastrimit, e cila lehtësohet fuqishëm nga informaliteti i madh i ekonomisë së Kosovës, gjë që e bën të vështirë të dallohet, nëse fondet merren legjitimisht apo jo. Vetëm tek mashtrimi dhe korrupsioni i nivelit të lartë mendohet se shumica e të ardhurave të tyre marrin formën fillestare të asetëve financiare.

Kosova kurrë nuk ka qenë objekt i sulmeve të mëdha terroriste, megjithatë duke marrë parasysh faktorët e tjerë se Kosova ka më së shumti luftëtarë për kokë banori në Evropë që kanë udhëtuar për në Siri dhe Irak dhe një numër i konsiderueshëm i tyre janë kthyer në Kosovë, Kosova nuk mund të injorojë kërcënimin e financimit të terrorizmit (FT). Duke pasur parasysh kërcënimin e brendshëm terrorist, kërcënimi më i rëndësishëm i FT, vjen nga vetëfinancimi ose nga donacionet më të vogla nga donatorët e me dëshirë/pa dëshirë, ndërkohë që FT përmes OJQ-ve, të cilat përfshijnë burime financimi jashtë Kosovës, gjithashtu përbëjnë një kërcënim thelbësor.

**Dokumenti i strategjisë është një shfaqje e masave të politikave,** të cilat Qeveria në bashkëpunim me partnerët e saj (donatorë dhe organizata financiare ndërkombëtare, organizata të shoqërisë civile, organizata profesionale dhe shoqata biznesi, qytetarë të të gjitha kategorive) synon të zbatojë në periudhën kohore 2019-2023 për të kufizuar dhe parandaluar të gjitha format e ekonomisë joformale në sektorë të ndryshëm të aktivitetit ekonomik në Kosovë. E njëjta synohet të veprojë si ndaj aktiviteteve legale të nënkuptuara si “ekonomia gri”<sup>1</sup> ashtu dhe aktiviteteve ilegale që në këtë Strategji emërtohen me termin “ekonomia e zezë”<sup>2</sup>.

**Në vet-vete ekonomia joformale si tërësi e ekonomisë gri dhe të zezë, minon përpjekjet e autoriteteve kombëtare** për të forcuar cilësinë e shtetit ligjor (p.sh. respektin e ligjit, eliminimin e korrupsionit, kriminalitetin etj.) dhe përmirësuar cilësinë e qeverisjes në ekonomi (p.sh. konkurrencën e drejtë dhe zbatimin e kontratave, të hyrat e buxhetit të Kosovës dhe shërbimet publike, mirëqenien ekonomike dhe sociale të banorëve të Kosovës etj.).


**Me gjithë rënien e shkallës së ekonomisë joformale prej 1% të Bruto Produktit Vendor (PBV) krahasuar me nivelin e para 2013, fenomeni mbetet gjerësisht prezent në Kosovë.**

<sup>1</sup> “Ekonomia gri” nënkupton format e aktivitetit legal të cilat i shmangen taksimit sipas legjislacionit tatimor të Kosovës.

<sup>2</sup> “Ekonomia e zezë” nënkupton format e aktivitetit jolegal të hyrat e të cilave janë të jashtëligjshme dhe për pasojë duhet të sekuestrohen në të gjitha format e tyre kurse subjektet e tyre duhet të ndëshkohen sipas dispozitave të parapara në legjislacionin penal të Kosovës.

Vlerësime të ndryshme të bëra nga Institucionet ndërkombëtare për hendekun flasin për një shifër afro 30% e BPV. Një vlerësimi i fundit sektorial i masës së ekonomisë joformale i financuar nga EU<sup>3</sup> në vitin 2017 me të dhënat statistikore të vitit 2015, gjeti që shkalla e ekonomisë joformale në Kosovë arrinte deri në 31.7% të , nga të cilat më tepër se 8% e BPV ishin me gjasë nga forma të paligjshme të aktivitetit ekonomik. Megjithëse Kosova renditej më mirë se disa prej vendeve të rajonit të cilat kanë një nivel më të lart të ekonomisë joformale (shih Fig. 2).

**Figura nr. 2: Shkalla në % e ekonomisë joformale në Kosovë në raport me vendet e rajonit dhe vendet e BE-së, 2017.**



Burimi: Kosovo, EU funded assessment, 2017; Schneider: <http://www.econ.jku.at/531/> for other countries.

Shkalla mesatare e ekonomisë joformale në botë vlerësohet të jetë rreth 30% e BPV-së<sup>4</sup>, ndërsa mesatarja e shkallës së ekonomisë joformale Evropiane sillet rreth 18% e BPV. Si model më i mirë për shkallën më të ulët mundë të veçojmë Zvicrën dhe atë me rreth 6% të BPV-së, pasuar nga vendet si Austria Luksemburgu dhe Holanda ku asnjëra nga këto shtete nuk e tejkalojnë 10% e BPV-së.

**Efekti negativ në të hyrat për buxhetin e Kosovës është i konsiderueshëm në terma të të hyrave nga tatimet direkte dhe indirekte<sup>5</sup>.** Në këtë drejtim sektorët më problematikë me prezencë të ekonomisë joformale janë: sektori i ndërtimit, shërbimeve sidomos hoteleri, restorante, tregtia dhe transporti<sup>6</sup>. Vlen të përmendet sektori i ndërtimit ku si rezultat i ndërtimeve masive pa

<sup>3</sup> “Further Support to Kosovo Institutions in fight against organized crime, corruption and violent extremism”

<sup>4</sup> [http://www.econ.jku.at/t3/staff/schneider/papers/Berdiev\\_Saunoris\\_Schneider\\_2018\\_Givemeliberty.pdf](http://www.econ.jku.at/t3/staff/schneider/papers/Berdiev_Saunoris_Schneider_2018_Givemeliberty.pdf)

<sup>5</sup> Sipas gjetjeve të të njëjtit vlerësim hendeku tatimor në TVSH është jo më pak se 33%, në TAK dhe TAP respektivisht 33% dhe 35%.

<sup>6</sup> Vlera e shmangieve tatimore dhe për rezultat dëmi për buxhetin e Kosovës në sektorin e ndërtimit vlerësohet të jetë jo më pak se 8 mill € kurse në tregti diku tek 11 mill €.



leje (350,000 të identifikuar dhe të raportuara) mundësia e pastrimit të të hyrave nga aktivitete të paligjshme mbetet e lartë.

Përveç efektit negativ në arkën e shtetit, ekonomia joformale e manifestuar përmes punësimit joformal, ndikon direkt në jetën e qytetarëve të Kosovës, duke ndikuar negativisht të tanishmen dhe të ardhmen e tyre. Sipas Agjencionit të Statistikave të Kosovës, në vitin 2016, 16% të të punësuarve nuk kishin kontratë pune, me përmirësim të ndjeshëm nga viti në vit. Përkundër përpjekjeve për të luftuar punësimin joformal, adresimi i këtij problemi kronik është si pasojë e sfidave në vijim: mungesa e informimit të publikut për efektet negative në afat të shkurtër dhe të gjatë; perceptimi nga punëdhënësit për rrezik të ulët të identifikimit dhe lidhur me pasojat nga punësimi joformal; efektiviteti i kufizuar i Inspektoratit të Punës si pasojë e numrit të kufizuar të inspektorëve dhe kushteve jo të mira të punës; dhe, bashkëpunimit të kufizuar ndër-institucional për parandalim dhe zvogëlim të punësimit joformal.

**Prezenca e ekonomisë joformale është një faktor që ka lehtësuar riciklimin e të ardhurave nga aktivitete të paligjshme, të cilat vazhdojnë të ekzistojnë ende në Kosovë.** Raporti mbi zgjerimin i BE-së kushtuar Kosovës (2018 me periudhe raportimi 2017) tërheq vëmendjen mbi ekzistencën e aktiviteteve të paligjshme si trafikimi i qenieve njerëzore me qëllim prostitucionin (në 2017, janë 32 raste të identifikuar nga të cilat 25 më nënshtetësi të Kosovës), krim i organizuar (9 raste të kallëzuara në organet e Prokurorisë), trafikim dhe përpunim i drogës (3,670 raste) korrupsion (700 rast të kallëzuara nga Autoriteti Anti-korrupsion), trafikimin e armëve (6 raste të identifikuar dhe të kallëzuara), etj.

**Prezenca e ekonomisë joformale në fusha të ndryshme të aktivitetit ekonomik shton konkurrencën e padrejtë, pabarazinë dhe varfërinë, të cilat kanë efekte negative për harmoninë e brendshme dhe qëndrueshmërinë e shoqërisë Kosovare.**

### III. VIZIONI DHE OBJEKTIVAT

#### Vizioni

Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Joformale, Pastrimin e Parave, Financimin e Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2019-2023, ka për qëllim zhvillimin e një sistemi të qëndrueshëm në Kosovë për të luftuar ekonominë joformale, financimin e terrorizmit dhe krimet tjera financiare për tu integruar në luftën rajonale dhe ndërkombëtare për të siguruar paqen sociale, mirëqenien, dinjitetin, barazi dhe zhvillim të qëndrueshëm ekonomik në përputhje me politikat e Qeverisë së Kosovës.

Ky është vizioni që orienton masat dhe aktivitetet e parapara në këtë dokument. Përmirësimi i punësimit, i burimeve publike, dhe forcimi i shtetit të së drejtës dhe i mirëqeverisjes janë fushat kryesore që kjo Strategji synon me vizionin e dokumentit themeltar të zhvillimit në Kosovë.

**Dy janë parimet bazë mbi të cilën janë zgjedhur masat e politikave dhe aktivitetet e shprehura në këtë Strategji:**

- **Pajtueshmëria vullnetare.** Për të trajtuar problemin e shtrirjes së ekonomisë joformale, një pjese e masave dhe aktivitetëve fokusohen në informimin, dhënien e stimuljeve fiskalë, krijimin e procedurave të thjeshta dhe të qarta administrative në mënyrë që të parandalohen shkeljet ligjore që kanë kosto për burimet materiale dhe financiare publike dhe private të qytetarëve të Kosovës. Këto kosto do të qartësohen dhe theksohen në mënyrë që zgjedhja e alternativave të veprimit nga qytetarët e Kosovës të jetë e qartë dhe kah drejtimit që parashikon kuadri ligjor.
- **Shtrëngesat ligjore.** Masat dhe aktivitetet e parapara këtu synojnë të bëjnë të mundur rritjen e efikasitetit të zbatimit të kuadrit ligjor ekzistues dhe, nëse mungon, krijimin e instrumenteve ligjore shtesë për të penalizuar format e ndryshme të ekonomisë joformale.

#### Objektivat Strategjikë

**Objektivi Strategjik I: Përmirësimi i cilësisë së qeverisjes në ekonomi nëpërmjet identifikimit, analizimit, trajtimit dhe monitorimit të luftimit të ekonomisë joformale, pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.** Ky objektivi ka të bëjë me **korrigjimin e problemit** të dëmtimit të cilësisë së qeverisjes ekonomike për shkak të ekonomisë joformale të shprehur si prani e konkurrencës së padrejtë, pabarazinë, moszbatim të kontratave, prani e artikujve të kontrabandës, punësimit joformal me të drejta të pakta të të punësuarve.


**Objektivi Strategjik II: Rritja e burimeve financiare për shërbimet publike si rezultat i të hyrave shtesë tatimore dhe nga konfiskimi i pasurisë së paligjshme.** Rrjedhë direkte e ekonomisë joformale është pakësimi i të hyrave nga tatimet në buxhetin e Kosovës dhe ekzistenca e pasurive të paligjshme private. Të dyja këto pasoja ndikojnë në sasinë e burimeve të përdorura për shërbimet publike dhe po ashtu rrisin shkallën e pabarazisë dhe të padrejtësive që kanë ndikim

negativ për stabilitetin dhe harmoninë e brendshme të shoqërisë Kosovare. Objektivi është pra që nëpërmjet masave dhe aktiviteteve të marra në Strategji këto dukuri **në terma sasiorë** të pakësohen.

### **Objektivat Specifikë**

**Kjo strategji ka një numër objektivash specifikë të cilat i shërbejnë arritjes së të dy objektivave strategjikë të shprehur më lartë.** Formulimi i tyre është bërë në përputhje me ciklin e formulimit dhe zbatimit të politikave publike dhe synon përmirësimin e tyre në mënyrë që të arrihen rezultate cilësore dhe sasiorë që kontribuojnë në arritjen e objektivave specifikë.

Figura nr. 3: Skema e Problemeve të Identifikuara dhe Përcaktimit të Objektivave



**OBJEKTIVI STRATEGJIK I: Përmirësimi i cilësisë së qeverisjes në ekonomi nëpërmjet identifikimit, analizimit, trajtimit dhe monitorimit të luftimit të ekonomisë joformale, pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.**

**Objektivi Specifik I.1: Përmirësimi cilësor i të dhënave për të mundësuar zhvillimin e politikave që në mënyrë të efektshme kontribuojnë në uljen e ekonomisë joformale.** Sfidat dhe problemet që synohen të zgjidhen nëpërmjet arritjes së këtij objekti kanë të bëjnë me rritjen e aftësisë që kanë autoritetet publike për të formuluar politika publike, të cilat i) janë të mbështetura në të dhëna apo evidencë për ekonominë joformale gri apo të zezë gri ii) rrjedhin nga informacione të verifikuara nga analiza e rrezikut të autoriteteve përkatëse iii) dhe janë të shënjestruara në atë çfarë synojnë të arrijnë. Disa nga aktivitetet bazë që synohen nën këtë masë kanë të bëjnë me:

**Masa për rritjen e pajtueshmërisë dhe shtrëngesës ligjore me efekt si për ekonominë gri ashtu dhe të zezë:**

- Avancimi në përdorimin e të dhënave/perfundimeve të anketave statistikore nga ASK (Agjencia për Statistikat e Kosovës) në modelet e vlerësimit të ekonomisë joformale në Kosovë, në parashikimet makro-fiskale të Ministrisë së Financave (MF) dhe masave politike të adresuara në strategji sektoriale
- Sigurimi i pajtueshmërisë së të dhënave të ASK lidhur me ekonominë joformale në përputhje me metodologjitë dhe standardet ndërkombëtare.
- Realizimi i anketës për çmimet e tokës bujqësore nga ASK.
- Përgatitja e një udhëzuesi mbi Metodologjinë e Vlerësimit të impaktit të ndryshimeve tatimore ( Tax Expenditure), i cili të zbatohet ose praktikohet përpara miratimit të çdo mase fiskale të propozuar.
- Specifikimi në thesar i komponentëve të pagesave nga tatimpaguesit: i) Gjore, ii) Ndëshkim iii) Interes iv) Shmangie tatimore v) Lloj Tatimi.
- Rritja e mbikëqyrjes nga BQK (Banka Qëndrore e Kosovës) për përshkrimin e transaksioneve financiare nga bankat në mënyrë që të rritet dobia e e informacionit për analiza cilësore në organet përkatëse
- Krijimi i një sistemi ndërbankar të pagesave me qëllim të stimulimit të pagesave me kartelë dhe formave të tjera të pagesave duke zvogëluar në masë përdorimin e keshit si mjet pagese.
- Dhënia e Kredive bankare bazuar në pasqyrat financiare të dorezuara në ATK dhe të certifikuara nga ekspertët e lëmisë për të gjitha bizneset që janë të obliguara të dorëzojnë pasqyrat në këtë institucion.
- Publikimi i vazhdueshëm i të dhënave të fushës së financave publike, sipas formatit të të dhënave të hapura, në Portalin Kombëtar për të Dhëna të Hapura.
- Zgjerimi i gamës së Vlerësimeve të Rrezikut nga NJIF (Njësia e Inteligjencës Financiare) duke shtuar vlerësimin e Sektorit Financiar.

**Objektivi Specifik I.2: Rritja cilësore e përmbushjes vullnetare përmes ngritjes së vetëdijes, raportimit dhe masave ligjore të kufizimit.** Ky objektivi synon të eliminojë politikat joefektive duke ndërmarr veprimet që mbështeten në dy qëllime kryesore: i) arritshmëria në terma të burimeve financiarë dhe njerëzore për zbatimin e politikave ii) ndikimi i pritshëm duke pasur

parasysh kontekstin e ekonomisë joformale në Kosovë. Disa nga aktivitetet bazë për të arritur zbatimin e kësaj mase mund të radhiten këto më poshtë:

#### **Masa për rritjen e pajtueshmërisë:**

- Rritja e aktiviteteve të komunikimit me publikun (numrin, pjesëmarrësve dhe buxhetet) për të rritur shkallën e ndërgjegjësimit të qytetarëve nga organet përgjegjëse për zbatimin e kësaj strategjie.
- Rritja e numrit të konferencave, punëtorive, takimeve të përbashkëta me shoqatat profesionale për të diskutuar ndikimin e masave të luftës kundër ekonomisë joformale, pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare (anëtarësisë së këtyre shoqatave, numri i pjesëmarrësve dhe dokumentet e konferencave).
- Pasqyrimi në raportin vjetor të zbatimit të strategjisë lidhur me të ardhurat nga ekonomia joformale gri dhe e zezë në faqen e internetit të MF.
- Të bëhet një studim lidhur me procesin e vlerësimit të çmimit të pronës, regjistrimit të të patundshmeve në rast blerje për herë të parë apo transferimi në mënyrë që vlera e asetit të regjistruar të pasqyrojë vlerën aktuale të tregut.
- Të funksionalizohet sistemi i unifikuar i adresave

#### **Masa për rritjen e shtrëngesës ligjore:**

- Përgatitja e koncept dokumentit lidhur me dorëzimin e deklaratës vjetore të tatimit mbi të ardhurat personale në ATK edhe nga personat fizik jo afarist.
- Përgatitja e koncept dokumentit lidhur me dorëzimin e deklaratës vjetore familjare të tatimit mbi të ardhurat personale në ATK edhe nga personat fizik jo afarist.
- Të gjitha pagesat e të punësuarve nga ana e punëdhënësit të bëhen nëpërmjet sistemit bankar.
- Rritja e numrit të bizneseve të pajisura me arka fiskale.
- Të implementohet fatura elektronike në sistemin e ri të TI-së në ATK.
- Miratimi i plotësim/ndryshimit të Ligjit për Financimin e Partive Politike dhe nxjerrja e akteve ligjore dhe nënligjore për publikimin dhe transparencën e informacionit të financave të Partive Politike
- Auditimi i pavarur i financave të Partive Politike dhe publikimi i rezultateve të tyre.
- Themelimi i njësisë për Rikthimin e Aseteve të Konfiskuara.
- Krijimi i fondit të konfiskimit në Kosovë.
- Fillimi i hetimit financiar që në fillim në raste kur dyshohet për krime të rënda dhe korrupsion në përputhje me rekomandimet e FATF-së.
- Aprovimi i Koncept dokumentit për përmirësimin e legjislacionit në fushën e Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe Luftimit të Financimit të Terrorizmit, në përputhje me praktikën e BE-së, rekomandimet e PECK II, Raportit të Vendit 2018.

**Objektivi Specifik I.3: Përmirësimi cilësor i kapaciteteve institucionale dhe bashkërendimit për zbatim më të mirë të politikave të miratuara.** Ky objektivi specifik adreson ngritjen e efijencës në zbatimin e politikave kundër ekonomisë joformale dhe synon **korrigjimin e saj nëpërmjet përmirësimeve** institucionale, procedurave, sistemeve të informacionit, koordinimit dhe integritetit të procesit të vendimmarrjes dhe zbatimit të masave të adoptuara. Po e njëjta synon procedurat e parapara që do të lejonin autoritetet të reagonin sa më shpejt që të jetë e mundur nëse diçka është zbatuar gabim për ta kthyer në drejtimin e duhur me koston më të ulët të mundshme. Disa aktivitete në këtë masë do të ishin:

**Masa për rritjen e pajtueshmërisë:**

- Përditësimi i vazhdueshëm i klasifikimit të aktivitetit ekonomik të bizneseve sipas nomenklaturës ndërkombëtare (NACE rev.2) dhe shkëmbimi i këtyre informacioneve në mes të ARKBBK-së, ATK-së dhe ASK-së.
- Intensifikimi dhe bashkërendimi i aktiviteteve në mes ATK dhe Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) me qëllim identifikimin dhe regjistrimin e punëtorëve të pa regjistruar, duke u bazuar në të dhënat e marra nga Agjencia e Statistikave të Kosovës në publikimin e anketave të ekonomisë joformale.
- Arritja e një memorandumi të mirëkuptimit midis Ministrisë së Drejtësisë dhe MF/ATK për të siguruar shkëmbimin e të dhënave nga noterët për transaksionet i) Në patundshmëri ii) Makina iii) Qira, i cili si minimum të ofrojë informacion mbi numrin e transaksioneve, tipin (blerje, transferim, qira), adresën, vlerën, subjektin (person fizik, biznes apo publik).
- Zhvillimi dhe prezantimi i moduleve të reja të programeve fiskale për të përmirësuar parashikimet fiskale për të ardhurat në sektorë.
- Publikimi dhe përditësimi i listës së High Risk Countries ( sipas publikimeve të FATF), lista e zeze EU, OECD lista e Gold Passports 2018.
- Rishikimi i metodologjisë së vlerësimit të Rrezikut NJIF sipas rekomandimeve të vlerësimeve dhe asistencës teknike në këtë fushë.
- Trajnimi dhe rritja e kapaciteteve në Divizionin e Ekonomisë joformale dhe llogarive qeveritare.
- Trajnimi për “Forecast consolidation” të Divizionit të Politikave Fiskale për “Tax Expenditures and Impact Assessment”.

**Objektivi Specifik I.4: Zvogëlimi i punësimit joformal në Kosovë.** Sfidat që synohen të adresohen me arritjen e këtij objektivi kanë të bëjnë me adresimin e efektivitetit të kufizuar të veprimeve për luftimin e punës joformale dhe adresimin e bashkëpunimit të kufizuar ndër-institucional. Disa nga aktivitetet bazë për të arritur zbatimin e kësaj mase mund të radhiten këto më poshtë:

**Masa për rritjen e pajtueshmërisë:**

- Realizimi i fushatave informuese për publikun e gjerë, lidhur me përfitimet dhe pasojat nga punësimi joformal dhe për informimin e punëdhënësve lidhur me pasojat në rast të punësimit joformal. Në këto fushata do të prezantohen edhe statistika për të theksuar rrezikun për identifikim të punëdhënësve që kanë punëtorë të pa formalizuar;
- Organizimit të aktiviteteve të përbashkëta me partnerët social, me qëllim të adresimit të punësimit joformal; dhe
- Realizimi i një analize lidhur me krijimin e regjistrimit të të punësuarve në kuadër të MPMS-së.

**Masa për rritjen e shtrëngesës ligjore:**

- Thellimi i bashkëpunimit ndër-institucional në luftimin e punësimit joformal;
- Analiza e gjendjes dhe vlerësimi i praktikave të mira për zvogëlimin e punës joformale. Kjo analizë do të ofrojë rekomandime konkrete për masat që duhet ndërmarrë të gjitha institucionet relevante për të parandaluar dhe luftuar punësimin joformal. Kjo analizë, po ashtu, pritet të

nxjerrë rekomandime konkrete për të mbështetur formalizimin e punësimit joformal, praktika që kanë treguar efekt në vendet me kontekst të ngjashëm si Kosova;

- Ngritja e kapaciteteve të inspektorëve të punës, përmes trajnimeve;
- Ndërtimi i një sistemi efikas për mbikëqyrjen dhe vlerësimin e punës së inspektorëve të punës;
- Ndërtimi i një metodologjie për sigurimin e një targetimi më të mirë, bazuar në shkallën e rrezikshmërisë; dhe
- Përmirësimi i kushteve të punës për Inspektoratin e Punës, përmes ndërtimit të sistemit të menaxhimit të informatave dhe përmirësimit të kushteve teknike të punës.

**OBJEKTIVI STRATEGJIK II: Rritja e burimeve financiare për shërbimet publike si rezultat i të hyrave shtesë tatimore dhe nga konfiskimi i pasurisë së paligjshme.**

**Objektivi Specifik II.1: Përmirësimi sasior i të dhënave për të mundësuar zhvillimin e politikave që në mënyrë të efektshme kontribuojnë në uljen e ekonomisë joformale.**

Disa nga aktivitetet bazë që synohen nën këtë masë kanë të bëjnë me:

**Masa për rritjen e pajtueshmërisë:**

- Kryerja e vlerësimeve të impaktit të masave të politikave të publikuara nga administrata e Kosovës me objektiv ekonominë joformale (Impact Assessments)
- Kryerja e studimeve apo vlerësimeve në fushën e ekonomisë joformale sipas standardeve ndërkombëtare lidhur me hendekun tatimor.

**Objektivi Specifik II.2: Rritja sasimore e përmbushjes vullnetare përmes ngritjes së vetëdijes, raportimit dhe masave ligjore të kufizimit.**

Si aktivitete bazë për të arritur zbatimin e kësaj mase mund të radhiten këto më poshtë:

**Masa për rritjen e pajtueshmërisë:**

- Ulja e pragut lidhur me transaksionet në mes bizneseve të cilat bëhen në kesh (aktualisht 500 EUR).
- Dizajnimi i Softuerit për arkat fiskale për të dhënë informata lidhur me: numrin e kuponëve fiskalë të lëshuar, kohën dhe artikujt- të gjitha këto në kohë reale (online).

**Objektivi Specifik II.3: Përmirësimi sasior i kapaciteteve institucionale dhe bashkërendimit për zbatim më të mirë të politikave të miratuara.**

**Masa për rritjen e pajtueshmërisë:**

- Rishikimi i formave standarde për shkëmbim të të dhënave elektronike dhe në bartës fizik me qëllim shkurtrimin e kohës së rrjedhës së informacionit në komunikimin ndër institucional dhe ndërkombëtar.
- Finalizimi i tabelës Sources/Uses nga ASK.
- Përmirësimi i kapaciteteve të parashikimeve fiskale për të ardhurat nëpër sektorë përmes instalimit të moduleve të reja krahas modelit të programimit fiskal.
- Zgjerimi i inspektimeve në sektorin e ndërtimtarisë dhe OJQ-ve, lidhur me FT (Financimi i Terrorizmit ) dhe PP (Pastrimi i Parave), ku inspektimet tek subjektet e caktuara që



paraqesin rrezik më të lartë, të bazohen në inteligjencën financiare, tatimore dhe kriminale (Target të jetë sektori i ndërtimtarisë).

- Krijimi i grupeve të përbashkëta DK dhe ATK me qëllim kontrollin e mallrave që kategorizohen me rrezik të lartë të shmangies së taksave.
- Hetimi dhe realizimi i operacioneve të përbashkëta me qëllim luftimin e kontrabandës së mallrave.
- Rritja e aktiviteteve të ndërmarra në parandalimin e mallrave që shkelin të drejtën e pronësisë Intelektuale – IPR.
- Rritja e numrit të patrullimeve të njësiteve anti kontrabandë me qëllim luftimin e kontrabandës.
- Aplikimi i kontrolleve pas importuese në bazë të menaxhimit të rrezikut dhe informacioneve tjera.
- Trajnim për ATK në fushën e menaxhimit të rrezikut.
- Trajnim për Doganat e Kosovës në fushën e zbatimit të Ligjit.
- Trajnime të dedikuara profesionalizim të Prokuroreve për veprën penale të krimit ekonomik dhe pastrimin e parave.
- Ngritja e aftësive profesionale në fushën e PP/FT për Prokuroret, Gjyqtaret, Hetuesit, dhe Inteligjenca Financiare.

#### **IV. ARANZHIMET E ZBATIMIT, MONITORIMIT DHE RAPORTIMIT**

##### **Monitorimi, raportimi dhe vlerësimi i zbatimit**

Monitorimi, raportimi dhe vlerësimi i zbatimit të dokumenteve strategjike është i rregulluar me Udhëzimin Administrativ 07/2018 për Planifikimin dhe Hartimin e Dokumenteve Strategjike dhe Planeve të Veprimit, më saktësisht me Kapitullin V *Vlerësimi i Përmbushjes së Prioriteteve dhe Raportimi*. Kështu, bazuar në këtë Udhëzim, Ministria e Financave si bartëse e këtij dokumenti strategjik, mban përgjegjësinë kryesore për koordinimin e aktiviteteve lidhur me hartimin, rishikimin, miratimin, zbatimin dhe monitorimin e Strategjisë Kombëtare 2019-2023 dhe Planit të saj të Veprimit 2019-2021. Kjo është sqaruar më shumë tek pjesa në vazhdim në kuadër të Sekretariatit.

Janë dy lloje raportimi ashtu siç kërkohet me Udhëzimin Administrativ 07/2018 të cilat do të kryhen për monitorimin, zbatimin dhe vlerësimin e zbatimit të Strategjinë për Luftimin e ekonomisë joformale, si në vijim:

- raporti vjetor mbi progresin e zbatimit (raportin e progresit) të dokumentit strategjik që duhet të përgatitet deri në fund të tremujorit të parë të vitit pasues, dhe
- raportin gjashtë mujor të monitorimit të planit të veprimit, duke u bazuar formatet e nevojshme që janë dhënë në Manualin për Hartimin e Dokumenteve Strategjike

Miratimi i raporteve do të bëhet në pajtim me Udhëzimin Administrativ 07/2018 më saktësisht neni 16 i Kapitullit V *Vlerësimi i Përmbushjes së Prioriteteve dhe Raportimi*, si dhe udhëzimeve të dhëna në këtë Strategji për miratimin e Raportit nga ana e Grupit Punues Qeveritar dhe shqyrtimit në Qeverinë e Kosovës.

Gjithashtu, ashtu siç kërkohet po me këtë Udhëzim, Ministria e Financave ka vendosur edhe strukturat koordinuese ndërministrore për të siguruar monitorim të rregullt të zbatimit të dokumentit në fjalë, duke përcaktuar qartë detajet rreth monitorimit, raportimit dhe rishikimit të ndërmjetëm dhe vlerësimit përfundimtar të zbatimit të dokumentit strategjik.

##### **Strukturat koordinuese**

Strukturat koordinuese ndërministrore janë vendosur në dy nivele: në nivelin e lartë qeveritar, që është Grupi Punues Qeveritar, i udhëhequr nga Ministri i Financave dhe i përbërë nga Ministrat përkatës që janë të ndërlidhura me Strategjinë për Luftimin e ekonomisë joformale dhe dikasteret përkatëse, si dhe nivelin teknik - Sekretariati, i cili po ashtu kryesohet nga Ministria e Financave. Në vazhdim janë dhënë më shumë sqarime rreth detyrave dhe përgjegjësiave të këtyre dy strukturave koordinuese. Ministria e Financave gjithashtu do të sigurojë këto organe me objektet dhe llojet e tjera të mbështetjes teknike që janë të nevojshme për punën e tyre.

## **Grupi Punues Qeveritar**

Grupi Punues Qeveritar është përgjegjës për hartimin, rishikimin, miratimin, zbatimin dhe monitorimin e Strategjisë Kombëtare të Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Jo-formale, Pastrimin e Parave, Financimin e Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2019-2023. Gjithashtu, ky Grup i paraqet propozimet për miratim Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Grupi Punues Qeveritar përbëhet nga përfaqësues të të gjitha ministrive dhe institucioneve përkatëse në lidhje me parandalimin e ekonomisë joformale, pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe krimeve financiare. Grupi Punues Qeveritar kryesohet nga Ministri i Financave.

Përbërja e Grupit Punues Qeveritar është si në vijim:

- Ministri i Financave, kryesues
- Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale;
- Ministri i Drejtësisë;
- Ministri i Punëve të Brendshme;
- Ministri i Tregtisë dhe Industrisë;
- Drejtori i Policisë së Kosovës;
- Drejtori i Doganës së Kosovës;
- Drejtori i Administratës Tatimore të Kosovës;
- Kryeprokurori i Shtetit;
- Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës;
- Kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës;
- Drejtori i Agjencisë Kosovare Kundër Korrupsionit;
- Drejtori i Njësisë së Inteligjencës Financiare të Kosovës.

Grupi Punues Qeveritar duhet të siguroj pjesëmarrjen e institucioneve relevante të sektorit privat dhe të tretë në implementimin dhe monitorimin e Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit 2019-2021. Kjo duhet të bëhet duke i ftuar përfaqësuesit e tyre në mbledhjet e Grupit Punues Qeveritar në rast se konsiderohet se është e nevojshme nga këndvështrimi i çështjes në fjalë.

Grupi Punues Qeveritar do të mbajë së paku dy (2) mbledhje brenda një viti kalendarik. Ai ndihmohet nga Sekretariati. Grupi Punues Qeveritar mund të angazhojë në punën e saj ekspertë të jashtëm, kur paraqitet nevoja.

## **Sekretariati i Grupit Punues Qeveritar**

Sekretariati është përgjegjës për të ndihmuar Grupin Punues Qeveritar. Ai do të përgatisë gjetjet dhe propozimet me shkrim lidhur me hartimin, rishikimin, miratimin, zbatimin dhe monitorimin e Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit 2019-2023.

Sekretariati nën udhëheqjen e Ministrisë së Financave, do të koordinojë aktivitetet rreth përgatitjes dhe hartimit të raportit vjetor mbi progresin e zbatimit (raportin e progresit) të dokumentit strategjik që duhet të përgatitet deri në fund të tremujorit të parë të vitit pasues, dhe raportin gjashtë mujor të monitorimit të planit të veprimit, duke u bazuar në formatet e nevojshme që janë dhënë në Manualin për Hartimin e Dokumenteve Strategjike. Duhet nënvizuar se nuk ka mbivendosje të detyrave dhe përgjegjësi ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Sekretariati sepse këto janë përcaktuar qartë në Udhëzimin Administrativ 07/2018 si dhe në këtë dokument strategjik. Ministria e Financave si institucion bartës për këtë strategji do të ofrojë tërë mbështetjen e nevojshme për funksionimin e Sekretariatit.

Sekretariati identifikon sfidat dhe pengesat për zbatimin e suksesshëm dhe propozon masat korrigjuese që duhet të ndërmerren nga institucionet zbatuese.

Sekretariati drejtohet nga një përfaqësues nga Ministria e Financave. Anëtarët e tjerë janë përfaqësues nga:

- Ministria e Financave, kryesuese;
- Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale;
- Zyra e Kryeministrit;
- Ministria për Integrim Evropian;
- Policia e Kosovës;
- Dogana e Kosovës;
- Administrata Tatimore e Kosovës;
- Banka Qendrore e Kosovës;
- Njësia e Inteligjencës Financiare të Kosovës;
- Agjencia e Statistikave të Kosovës;
- Ministria e Tregtisë dhe Industrisë;
- Ministria e Drejtësisë;
- Koordinatorit Kombëtarë për luftimin e krimit ekonomik

Sekretariati do të mbajë së paku katër (4) takime brenda një viti kalendarik. Ai mund të angazhojë në punën e saj ekspertë të jashtëm, kur vlerësohet të jetë e nevojshme.

### **Institucionet e obliguara të sektorit publik, privat dhe të tretë**

Zbatimi i Strategjisë Kombëtare 2019 - 2023 është i bazuar në një partneritet në mes institucioneve të sektorit publik, privat dhe të tretë. Përgjegjësitë e tyre janë të specifikuara në Planin e Veprimit.

### **Hartimi, rishikimi dhe miratimi i strategjisë kombëtare dhe plani i veprimit**

Përgjegjësitë për hartimin, rishikimin dhe miratimin e Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit 2019 - 2023 janë si më poshtë:

- Ministritë dhe institucionet që janë anëtarë të Grupit Punues Qeveritar duhet të vlerësojnë mjedisin e tyre strategjik dhe operativ në lidhje me parandalimin e ekonomisë joformale, pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe krimeve financiare. Ata duhet të marrin parasysh aktivitetet e homologëve të sektorit publik, privat dhe të tretë që janë nën mbikëqyrjen e tyre, ose që veprojnë në sferën e tyre të autoritetit dhe janë relevante në këtë kontekst;
- Ministritë dhe institucionet të cilat janë të përfaqësuar në Grupin Punues Qeveritar duhet të raportojnë përmes përfaqësuesve të tyre në Grupin Teknik Punues në lidhje me gjetjet e tyre që kanë të bëjnë me parandalimin e ekonomisë joformale, pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe krimeve financiare në Sekretariat të paktën katër (4) herë brenda një viti kalendarik dhe menjëherë nëse kërkojnë nevojat strategjike apo operative;
- Sekretariati do të analizojë informacionin i cili është siguruar nga organizatat anëtare të Grupit Punues Qeveritar. Rezultatet duhet të merren parasysh gjatë hartimit ose rishikimit të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit 2019-2023. Sekretariati do të përgatisë propozime me shkrim;
- Sekretariati do të prezantojë propozimet me shkrim për Grupin Punues Qeveritar që do të merren në konsideratë gjatë hartimit, rishikimit apo përshtatjes së Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit 2019-2023;
- Grupi Punues Qeveritar me mbështetjen e Sekretariatit do të jetë përgjegjës për hartimin e propozimeve në lidhje me hartimin, rishikimin apo përshtatjen e Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit 2019-2023;
- Grupi Punues Qeveritar do të prezantojë propozime që lidhen me hartimin, rishikimin apo përshtatjen e Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit 2019-2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës së paku dy (2) herë brenda një viti kalendarik dhe menjëherë nëse kërkojnë nevojat strategjike ose operative; dhe
- Qeveria e Republikës së Kosovës do të vendos për miratimin e Strategjisë Kombëtare dhe Planin e Veprimit bazuar në propozimet e Grupit Punues Qeveritar 2019-2023.

## **Zbatimi dhe monitorimi i strategjisë kombëtare dhe planit të veprimit**

### **Përgjegjësitë për zbatimin dhe monitorimin**

Përgjegjësitë që lidhen me zbatimin dhe monitorimin e Planit të Veprimit dhe Strategjisë Kombëtare 2019 - 2023 janë si më poshtë:

- Institucionet publike të obliguara të cilat do të jenë përgjegjëse për zbatimin e Strategjisë Kombëtare 2019-2023 janë të përcaktuara në Planin e Veprimit;
- Autoritetet mbikëqyrëse do të jenë institucione të obliguara në lidhje me zbatimin e aktiviteteve të institucioneve të sektorit privat ose të treta të cilat janë nën mbikëqyrjen e tyre;
- Qeveria e Republikës së Kosovës, ministritë dhe institucionet publike relevante do të sigurojnë që përgjegjësia për zbatimin e Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit 2019-2023 janë pjesë integrale e detyrave zyrtare të institucioneve publike të obliguara. Prandaj, objektivat e

Strategjisë dhe veprimet e Planit të Veprimit do të integrohen në buxhetet e tyre dhe Planet e Performancës;

- Institucionet e obliguara do të raportojnë katër (4) herë brenda një viti kalendarik përmes përfaqësuesve të tyre në Grupin Teknik Punues në lidhje me rezultatet e zbatimit të planit të veprimit të Sekretariatit. Ata do të bashkëngjisin shabllonin e monitorimit në Shtojcën 2 të raporteve të tyre. Sekretariati do të vendosë orarin e saktë për raportet;
- Sekretariati do të hartojë katër (4) herë brenda një viti kalendarik, një raport për rezultatet e procesit të zbatimit dhe monitorimit. Ajo duhet të bashkëngjis shabllonin e monitorimit në Shtojcën 2 në draft-raportin e tij;
- Sekretariati duhet të raportoj të paktën dy (2) herë brenda një viti kalendarik për rezultatet e procesit të zbatimit dhe monitorimit të Grupit Punues Qeveritar. Ajo duhet të bashkëngjis shabllonin e monitorimit në Shtojcën 2 në draft-raportin e tij; 7. Grupi Punues Qeveritar do të raportojë dy (2) herë brenda një viti kalendarik rezultatet e procesit të monitorimit të zbatimit për Qeverinë e Republikës së Kosovës duke përdorur raportin e hartuar nga Sekretariati. Shablloni i monitorimit në Shtojcën 2 do të bashkëngjitet raportit;
- Qeveria e Republikës së Kosovës do të vendosë lidhur me masat e zbatimit të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit bazuar në raportimin e Grupit Punues Qeveritar 2019-2023. Vendimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me zbatimin dhe masat e mundshme korrigjuese do të regjistrohen në një vendim qeveritar dhe në shabllonin e monitorimit në Shtojcën 2;
- Vendimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me zbatimin e masave të mundshme korrigjuese duhet t'i njoftohen institucioneve të obliguara nga ana e Sekretariatit, duke u dërguar atyre vendimin me shabllonin e monitorimit në Shtojcën 2; dhe
- Qeveria e Republikës së Kosovës do të ketë përgjegjësi të përgjithshme për zbatimin dhe monitorimin e Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit 2019-2023.

### Treguesit për monitorimin e Strategjisë

Strategjia do të monitorohet sipas treguesve të paraqitur në tabelën e mëposhtme. Vlerat e bazës për treguesit e mësipërme janë diskutuar dhe pajtuar me specialistët e fushave përkatëse në lidhje me të dhënat statistikore dhe metodologjinë e mbledhjes.

**Tabela 1: Indikatorët e Monitorimit të arritjes së Objektivave të Strategjisë**

Jo.	Objektivi / Treguesi	Vlera bazë 2019	Synimi afatmesëm 2019-2021	Synimi i vitit të fundit 2023
I.	<b>Objektivi strategjik 1: Përmirësimi i cilësisë së qeverisjes në ekonomi nëpërmjet identifikimit, analizimit, trajtimit dhe monitorimit të luftimit të ekonomisë joformale, pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.</b>			
1.	<i>Zvogëlimi i shkallës së ekonomisë joformale</i>	<b>31.7%</b> <i>(sipas vlerësimit për vitin 2017)</i>	<b>29%</b>	<b>26%</b>

<b>I. i.</b>	<b>Objektivi specifik 1: Përmirësimi cilësor i të dhënave për të mundësuar zhvillimin e politikave që në mënyrë të efektshme kontribuojnë në uljen e ekonomisë joformale.</b>			
2.	% e masave me arsytim të ndikimit të masës së publikuar sipas metodologjisë “ Vlerësimi i impaktit ” në lidhje me informalitetin.	50% vjetore , 100% pas daljes se metodologjise	100%	100%
<b>I. ii.</b>	<b>Objektivi specifik 2: Rritja cilësore e përmbushjes vullnetare përmes ngritjes së vetëdijes, raportimit dhe masave ligjore të kufizimit.</b>			
3.	Përqindja (%) e efektit real ndaj efektit të përlogaritur për çdo masë dhe në total (TADAT P1-1, P5-15, P6-16 në fushën e tatimeve )	-	70-80%	90-100%
<b>I. iii</b>	<b>Objektivi specifik 3: Përmirësimi cilësor i kapaciteteve institucionale dhe bashkërendimit për zbatim më të mirë të politikave të miratuara.</b>			
4.	% mesatare çështjeve të mbyllura ndaj totali në vit për shmangiet tatimore ose veprimet jolegale.	50%	70%	70%
5.	% e zyrtarëve publikë që janë trajnuar mbi (5 ) ditë ne vit ndaj totalit në aspekte të ndryshme të ekonomisë joformale: koncepte, metodologji dhe analiza.	Mesatarja e Institucioneve politikberese 50%	Mesatarja e Institucioneve politikberese 70%	Mesatarja e Institucioneve politikberese 90-100%
<b>I. iv</b>	<b>Objektivi specifik 4: Zvogëlimi i punësimit joformal në Kosovë.</b>			
6.	Shkalla e punësimit joformal	14%	12%	10%
<b>II.</b>	<b>Objektivi strategjik 2: Rritja e burimeve financiare për shërbimet publike si rezultat i të hyrave shtesë tatimore dhe nga konfiskimi i pasurisë së paligjshme.</b>			
7.	% e të hyrave tatimore nga ngushtimi i hendekut tatimor.	Nese masat implementohen qe ne vitin 2019 50% ose 28 mil euro qe i korrespondon. Ne përqindje te GDP Midis 0.02-1%	14 mil euro (% Kumulative 75%)	14 mil euro (100% kumulative)
8.	Konfiskimet finale të pasurive të jashtëligjshme si % e pasurive të konfiskuara.	Me e madhe se 50% e vlerës se Sekuestruar ne vitin 2019, 2020 dhe ne vlere jo me pak se 500000 euro	Ne vlere jo me pak se 1 mil euro dhe 70% e vlerës se Sekuestruar	Ne vlere jo me pak se 1 mil euro dhe 70% e vlerës se Sekuestruar
<b>II. i.</b>	<b>Objektivi specifik 1: Përmirësimi sasior i të dhënave për të mundësuar zhvillimin e politikave që në mënyrë të efektshme kontribuojnë në uljen e ekonomisë joformale.</b>			
9.	Numri i studimeve ose vlerësimeve të realizuara çdo vit për ekonominë joformale (psh.hendeku tatimor, llogaritë kombëtare jo të kompletuara, residuals, errors and omissions etc.)	>3 (tre impact Assessment dhe 2 Tax Gap assessments)	>2 (Tax Gap Assessments pervec Impact Assessments)	>2 Tax Gap Assessmentss
<b>II. ii.</b>	<b>Objektivi specifik 2: : Rritja sasore e përmbushjes vullnetare përmes ngritjes së vetëdijes, raportimit dhe masave ligjore të kufizimit.</b>			

10.	<i>% e rritjes së bazës tatimore për lloj të tatimi dhe sektor me ekspozim të lartë ndaj ekonomisë joformale.</i>	Jo me pak se 2 % si mesatare e të gjithave llojeve të tatimeve për të arritur në gap të TAK, TVSH dhe TAP ( 29-33%)	Jo me pak se 2,5% si mesatare e të gjithave llojeve të tatimeve për të arritur në gap të TAK, TVSH dhe TAP (27-31%)	Jo me pak se 2.5 % si mesatare e të gjithave llojeve të tatimeve për të arritur në gap të TAK, TVSH dhe TAP (26-30%)
11.	<i>% e rritjes së konfiskimeve të pasurive të paligjshme në sektorët e veprimtarisë me risk të lartë.</i>	Me e madhe se 50% e vlerës së Sekuestruar në vitin 2019 dhe në vlerë jo me pak se 750000 euro	Në vlerë jo me pak se 1.25 mil euro dhe 75% e vlerës së Sekuestruar në vitin 2020	Në vlerë jo me pak se 1.5 mil euro dhe 75 % e vlerës së Sekuestruar në vitin 2021
<b>II. iii</b>	<b>Objektivi specifik 3: Përmirësimi sasior i kapaciteteve institucionale dhe bashkërendimit për zbatim më të mirë të politikave të miratuara.</b>			
12.	<i>% e nismave legale që ulin kohën e ndërveprimit institucional mbi 10 dite në krahasim me vlerën aktuale dhe nuk rrisin numrin e hallkave të administrimit të kërkesës për procedurë administrative.</i>	50%	100%	100%
13.	<i>Numri i trajnimeve lidhur me ekonominë joformale dhe veprimtaritë e paligjshme.</i>	10 trajnime me nga 20 pjesëmarrës	14 trajnime me nga 20 pjesëmarrës	18 trajnime me nga 20 pjesëmarrës



## V. NDIKIMI BUXHETOR DHE ZBATIMI I STRATEGJISË

Ndikimi Buxhetor i Strategjise sipas objektivave, viteve dhe strukture së Shpenzimeve jepet në Tabellen e mëposhtme.

	Buxheti 2019-2021			Buxheti 2019			Buxheti 2020			Buxheti 2021		
	Total	Rrjedhes	Kapital	Total	Rrjedhes	Kapital	Total	Rrjedhes	Kapital	Total	Rrjedhes	Kapital
<b>VISION: ZHVILLIMI I NJË SISTEMI TË QËNDRUESHËM NË KOSOVË PËR TË LUFTUAR EKONOMINË JOFORMALE ME QËLLIM PËRMIRËSIMIN E MIRËQENIES EKONOMIKE DHE SHOQËRORE TË QYTETARËVE TË KOSOVËS.</b>	6,147.91	5,929.14	218.77	1,703.12	1,611.87	91.25	2,425.59	2,318.07	107.52	2,019.20	1,999.20	20.00
	100%	96.44%	3.56%	100%	94.64%	5.36%	100%	95.57%	4.43%	100%	99.01%	0.99%
<b>Objektivi Strategjik I: Përmirësimi i cilësisë së qeverisjes në ekonomi nëpërmjet identifikimit, analizimit, trajtimit dhe monitorimit të luftimit të ekonomisë joformale, pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.</b>												
<b>Objektivi specifik I.1:</b> Përmirësimi cilësor i të dhënave për të mundësuar zhvillimin e politikave që në mënyrë të efektshme kontribuojnë në uljen e ekonomisë joformale.	737.54	737.54	-	247.77	247.77	-	261.00	261.00	-	228.77	228.77	-
	100%	100%	0%	100%	100%	0%	100%	100%	0%	100%	100%	0%
<b>Objektivi Specifik I.2:</b> Rritja cilësore e përmbushjes vullnetare përmes ngritjes së vetëdijes, raportimit dhe masave ligjore të kufizimit.	3,903.86	3,903.86	-	840.57	840.57	-	1,598.53	1,598.53	-	1,464.76	1,464.76	-
	100%	100%	0%	100%	100%	0%	100%	100%	0%	100%	100%	0%
<b>Objektivi Specifik I.3:</b> Përmirësimi cilësor i kapaciteteve institucionale dhe bashkërendimit për zbatim më të mirë të politikave të miratuara.	240.84	169.59	71.25	119.14	47.89	71.25	63.68	63.68	-	58.02	58.02	-
	100%	70%	30%	100%	40%	60%	100%	100%	0%	100%	100%	0%
<b>Objektivi specifik I.4:</b> Objektivi Specifik I.4: Zvogëlimi i punësimit joformal në Kosovë	210.99	150.99	60.00	66.33	46.33	20.00	112.33	92.33	20.00	32.33	12.33	20.00
	100%	72%	28%	100%	70%	30%	100%	82%	18%	100%	38%	62%
<b>Objektivi Strategjik II: Rritja e burimeve financiare për shërbimet publike si rezultat i të hyrave shtesë tatimore dhe nga konfiskimi i pasurisë së paligjshme.</b>												
<b>Objektivi specifik II.1:</b> Përmirësimi sasior i të dhënave për të mundësuar zhvillimin e politikave që në mënyrë të efektshme kontribuojnë në uljen e ekonomisë joformale.	410.36	410.36	-	156.28	156.28	-	32.60	32.60	-	221.48	221.48	-
	100%	100%	0%	100%	100%	0%	100%	100%	0%	100%	100%	0%
<b>Objektivi Specifik II.2:</b> Rritja sasiore e përmbushjes vullnetare përmes ngritjes së vetëdijes, raportimit dhe masave ligjore të kufizimit.	12.00	12.00	-	-	0	-	12.00	12.00	-	-	-	-
	100%	100%	0%	100%	-	-	100%	100%	0%	100%	-	-
<b>Objektivi Specifik II.3:</b> Përmirësimi sasior i kapaciteteve institucionale dhe bashkërendimit për zbatim më të mirë të politikave të miratuara.	821.15	733.63	87.52	273.01	273.01		345.43	257.91	87.52	202.71	202.71	-
	100%	89%	11%	100%	100%	0%	100%	75%	25%	100%	100%	0%

## **SHTOJCAT**

- Dokumenti i Kostimit
- Pasaporta e Indikatorëve
- Vendimi për ngritjen e Grupit të Punës

**PLANI I VEPRIMIT 2019-2021, lidhur me zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Jo-formale, Pastrimin e Parave, Financimin e Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2019-2023.**

Legjende:      Niveli i Pare: Shifrat ne 000 Eur  
 Niveli i Dyte: Buxh- Buxheti i Kosoves, Don- Donator  
 Niveli i Trete E paangazhuar  ; E diskutuar por e Pamiraturar  ; E angazhuar   
 Institucioni Udheheqes: **E zeze e theksuar**

Nr.	Objektivat strategjike dhe specifike, treguesit dhe veprimet	Vlerat bazë të sugjeruara [2019]	Objektivi i përkohshëm [2019-2021]	Synimi i vitit të fundit [2023]	Rezultati				
<b>VIZION: TË PËRMIRËSOHET MIRËQENIA EKONOMIKE DHE SHOQËRORE E QYTETARËVE TË KOSOVËS DHE TË MUNDËSOHET PËRPARIMI NE PROCESIN E INTEGRIMIT EVROPIAN.</b>									
<b>I.</b>	<b>OBJEKTIVI STRATEGJIK I: Përmirësimi i cilësisë së qeverisjes në ekonomi nëpërmjet identifikimit, analizimit, trajtimit dhe monitorimit të luftimit të ekonomisë joformale, pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit</b>								
	<i>Zvogëlimi i shkallës së ekonomisë joformale</i>	31.7% (sipas vlerësimit për vitin 2017)	29%	26%	Shkalla e ekonomisë joformale e zvogëluar.				
<b>I</b>	<b>Objektivi specifik 1: Përmirësimi cilësor i të dhënave për të mundësuar zhvillimin e politikave që në mënyrë të efektshme kontribuojnë në uljen e ekonomisë joformale.</b>								
	<b>Treguesi:</b> <i>Përqindja (%) e masave me arsytet të ndikimit të masës së publikuar sipas metodologjisë “Vlerësimi i impaktit” në lidhje me informalitetin.</i>	50% ne rastin me të mire përderisa metodologjia nuk është gati	100%	100%	Masat e parapara nga Qeveria e Kosovës me fokus formalitetin janë të justifikuar me një analizë cilësore dhe sasiore të ndikimit i cili merr parasysh të paktën i) kontekstin ii) efektivitetin iii) eficienten iv) burimet në dispozicion				
Nr.	Veprimi	Afati i fundit	Buxheti			Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës dhe mbështetës	Produkti	Referenca në dokumente
			2019	2020	2021				
1.1.1	Avancimi në përdorimin e të dhënave të anketave statistikore nga ASK (Agjencia për Statistikat e Kosovës) në modelet e vlerësimit të ekonomisë joformale në Kosovë, në parashikimet makro-fiskale të Ministrisë së Financave (MF) dhe masave politike të adresuara në strategji sektoriale	K1 2020 dhe pas vazhdimit	-	3.2	-	Buxh <input type="checkbox"/>	MF/ DPMBNF	Referenca dhe të dhënat e anketave të ASK mbi ekonominë e pa vrojtuar janë pjesë e studimeve/publikimeve të parashikimeve makro-fiskale të MF	Publikimet zyrtare të MF Publikimet e ASK

1.1.2	Sigurimi i pajtueshmërisë së të dhënave të ASK lidhur me ekonominë joformale në përputhje me metodologjitë dhe standardet ndërkombëtare.	K4 2020	160	160	160	Buxh. 480 □	<b>ASK</b>	Raportime të përditësuara të treguesve /dhënave statistikore.	Publikimet Zyrtare të ASK
1.1.3	Realizimi i anketës për çmimet e tokës bujqësore nga ASK.	K4 2021	-	29.5	29.5	Buxh. 59 □	<b>ASK</b>	-Plani i Punës Vjetor i ASK i cili përmban këtë aktivitet i miratuar -Buxheti i alokuar -Anketa e Zhvilluar dhe Rezultatet e Publikuara në formën e paraparë nga ASK	Publikime të ASK dhe MF
